

Numër.....

Podgoricë.....

## **PROCESVERBAL**

nga mbledhja e tretë e rregullt e Komisionit për përmbajtjet programore në gjuhën shqipe dhe gjuhët e pjesëtarëve të popujve tjerë pakicë dhe bashkësitë tjera të pakicave nacionale

Mbledhja e Komisionit u mbajt më 30.05.2022.

Në mbledhje morën pjesë:

1. Admir Adroviq – kryetar
2. Veron Halili – anëtar
3. Tripo Matijeviq – anëtar
4. Frashër Selimaj – anëtar, i cili mori pjesë në punën e mbledhjes përmes aplikacionit ZOOM

Mirheta Gaçeviq dhe Ivana Krushçiq, anëtare nuk morën pjesë në mbledhje për shkak të obligimeve të mëparshme për ç'gjë e njoftuan kryetarin e Komisionit.

Krahas anëtarëve të Komisionit në mbledhje mori pjesë edhe Ivan Llekoviq, sekretar i Komisionit.

Në mbledhje u miratua

### **RENDI I DITËS**

1. Diskutim dhe deklaram për procesverbalin nga mbledhja e dytë e rregullt e Komisionit
2. Diskutimin dhe deklaramin për propozim-tekstin e rregullores për punën e Komisionit të përmbajtjeve programore në gjuhën shqipe dhe gjuhët e pjesëtarëve tjerë të popujve pakicë dhe bashkësive të pakicave tjera nacionale, pas miratimit të Këshillit të RTMZ.
3. Të ndryshme.

#### **I**

Procesverbali nga mbledhja e dytë e Komisionit u miratua me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm (4 vota për).

#### **II**

Admir Adroviq i njoftoi të pranishmit se është fituar miratimi nga Këshilli i RTMZ dhe se janë bërë disa ndryshime në tekstin e propozimit të Rregullores. Ndryshimet kishin të bënin:

1. Lidhur me propozimet e ndryshimet me rastin e vendosjes, në rast që të jetë i barabartë numri i votave, por edhe kundër, vota e kryetarit nuk do të jetë vendimtare, respektivisht për çdo vendim do të nevojitet që të votohet nga shumica e anëtarëve të pranishëm nëse është e pranishme shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.
2. Për vërtetimin e akteve të cilat Komisioni i zgjedh çështjet nga përgjegjësia e vet ose komunikon me organet, institucionet dhe me persona tjerë juridik dhe me qytetarë do të përdoret vula e Këshillit

të RTMZ e jo vula siç ishte rasti deri tani, përveç në situatat kur propozimet e Komisionit i miraton Këshilli i RTMZ para se të shpallen ose t'i dërgohen ndonjë organi tjetër.

Frashër Selimaj e paraqiti qëndrimin e vet që konsideron se vota e Kryetarit është dashtë të mbetet vendimtare në rast se nuk ka shumicë, mirëpo, nëse kjo është e pranueshme për anëtarët tjerë atëherë as ai nuk do të jetë kundër ndryshimeve të cekura.

Propozimi i rregullores u miratua me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm. (4 vota për)

### III

Duke pasur parasysh se është planifikuar që në mbledhjen e ardhshme të Komisionit të ftohen redaktorët e programeve në gjuhën shqipe dhe gjuhet e pjesëtarëve tjerë të popujve pakicë dhe bashkësive të pakicave tjera nacionale nga TVMZ, Tripo Matijeviq kërkoi që të sigurohet shqyrtimi i Planit programor dhe të produksionit të TVMZ, RMZ, MMC, si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tyre për vitin rrjedhës. Po ashtu theksoi se Komisioni jep mendimin për iniciativat për aktet e përgjithshme që cilat rregullojnë çështjet e standardeve programore dhe profesionale në RTMZ dhe kanë të bëjnë në lëmit e popujve pakicë dhe bashkësive tjera dhe se menaxhmenti i RTMZ do të duhej t'u dorëzojë këto propozime që Komisioni të jap mendimin e vet para se ato të propozohen për miratim nga anëtarët e Këshillit të RTMZ.

Admir Adroviq i njoftoi anëtarët tjerë se Këshillit të RTMZ do t'i dërgohet iniciativa me tri pika, lidhur me përfundimet nga mbledhja e kaluar, e që kanë të bëjnë me çështje të përdorimit të shkrimit cirilik, korrespondentit nga Plava dhe Gucia dhe shumës së kompensimit për anëtarët e Komisionit.

PROCESVERBALIN E MBAJTI  
IVAN LEKOVIQ

KRYETARI I KOMISIONIT  
ADMIR ADROVIQ